VENDIM
Nr. 200, datë 25.3.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË MIRDITË DHE KAMZË, DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE

(ndryshuar me VKM nr. 164, datë 18.3.2022, nr. 372, datë 1.6.2022; nr. 783, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Mirditë dhe Kamzë, në masën "... *746 547 342 (shtatëqind e dyzet e gjashtë milionë e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH*, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Mirditë, në masën 102 720 089 (njëqind e dy milionë e shtatëqind e njëzet mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për:

i. rikonstruksionin dhe sistemin e ngrohjes së godinës nr. 3 (3 kate), shkolla 9-vjeçare "Pashko Vasa", Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 45 969 907 (dyzet e pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatë) lekë pa TVSH;

ii. rikonstruksionin e kopshtit të fëmijëve (godina e vjetër), Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 23 544 114 (njëzet e tre milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë e njëqind e katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

iii. rikonstruksionin e kopshtit të fëmijëve me aftësi ndryshe (ish-godina e SHIK-ut), Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 33 206 068 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

b) Bashkisë Kamzë, në masën *643 827 253 (gjashtëqind e dyzet e tre milionë e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH*, për:

i. rikonstruksionin e gjimnazit "Isa Boletini", Bashkia Kamzë, në masën 292 810 000 (dyqind e nëntëdhjetë e dy milionë e tetëqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH;

ii. rikonstruksionin e kopshtit "Zall Mner", Bashkia Kamzë, në masën 71 400 000 (shtatëdhjetë e një milionë e katërqind mijë) lekë pa TVSH.

iii. rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari", Zall Mner, Bashkia Kamzë, në masën 279 617 253 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkitë Mirditë dhe Kamzë, në masën 93 386 017 (nëntëdhjetë e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, detajohet, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi në masën 20 544 017 (njëzet milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 72 842 000 (shtatëdhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë, për rikonstruksionin e objekteve arsimore, në masën 346 791 450 (treqind e dyzet e gjashtë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë

e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari", Zall-Mëner, Bashkia Kamzë, fondi në masën 55 923 450 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022;

b) për rikonstruksionin e gjimnazit "Isa Boletini", fondi në masën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe 184 248 000 (njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e dyqind e dyzet e tetë mijë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë;

c) për rikonstruksionin e kopshtit Zall-Mëner, fondi në masën 56 620 000 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Mirditë, për rikonstruksionin e objekteve arsimore, në masën 49 636 970 (dyzet e nëntë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet Bashkisë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/3. Përveç përcaktimeve të pikës 2/2, të këtij vendimi, përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 29 438 505 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Mirditë, të detajuar, si më poshtë vijon:

a) Rikonstruksion dhe sistem ngrohjeje i godinës nr. 3 (3 kate), shkolla 9-vjeçare "Pashko Vasa", Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 14 859 730 (katërmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar;

b) Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve (godina e vjetër) Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 4 216 892 (katër milionë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar;

c) Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve me aftësi ndryshe (ish-godina e SHIK-ut) Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 10 361 883 (dhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e bashkive Mirditë dhe Kamzë si njësi zbatuese për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Mirditë e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe